

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 2219 Prot.
(Lutemi referojuni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 13.07.2020


REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 449 Prot.
(Lutemi referojuni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 13.07.2020

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 61, Datë 13/07/2020

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT PËR
KATEGORINË E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE**

Në mbështetje të Ligjit nr.69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8, datë 26.03.2020, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.98, datë 27.02.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore,

URDHËROJ

1. Miratimin e kalendarit "Për zhvillimin e provimit për kategorinë e kualifikimit të mësuesve", sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri. Lista emërore e kandidatëve pjesëmarrës në provim me oraret përkatëse do të publikohet në faqet e internetit të QSHA.

2. Provimi me shkrim për kategoritë e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2019-2020, do të zhvillohet në datat 20, 21, 22, 23 dhe 24 korrik 2020, ora 10-12:30, në Tiranë në institucionet arsimore, gjimnazi “Ismail Qemali” dhe shkolla 9-vjeçare “1 Maji”.
3. Kandidati paraqitet në qendrën e provimit së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit.
4. Kandidati duhet të respektojë rregullat e distancimit fizik dhe të higjienës.
5. Në ditën e provimit, secili kandidat duhet të mbajë detyrimisht maskë dhe doreza dhe të respektojë distancimin fizik
6. Në ditët e provimeve, largësia e çdo kandidati, gjatë hyrjes në qendrën e provimeve dhe gjatë zhvillimit të provimit, do të jetë në distancë të paktën 1.5 metër nga kandidati tjetër.
7. Të gjithë personat e përfshirë në administrimin e procesit të kualifikimit të mësuesve, të kenë detyrimisht maskë dhe doreza gjatë gjithë procesit dhe të respektojnë distancimin fizik.
8. Mjediset ku do të zhvillohen provimet e kualifikimit të mësuesve, të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të dezinfektuara.
9. Personi i caktuar nga QSHA, kryen për çdo kandidat procedurën si më poshtë:
 - i. mat temperaturën në ballë me termometër digjital.
 - ii. kontrollon nëse çdo kandidat është i pajisur me maskë dhe doreza.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

**Për Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë
së Arsimit Parauniversitar**


Drejtoresha e Përgjithshme

Drejtori i Përgjithshëm

Znj. Rezana VRAPI



Z. Gerti JANAQI



Kalendari për zhvillimin e provimit për kategorinë e kualifikimit të mësuesve

Nr	Cikli	Data
1	AF (Arsimi Fillor)	20 korrik 2020
2	AML (Arsimi i Mesëm i Lartë)	21 korrik 2020
3	AMU (Arsimi i Mesëm i Ulët)	22 korrik 2020
4	AMU (Arsimi i Mesëm i Ulët)	23 korrik 2020
5	AP (Arsimi Profesional)	24 korrik 2020
	APSH (Arsimi Parashkollor)	24 korrik 2020
	AS (Arsimi Special)	24 korrik 2020
	ASK (Arsimi Social Kulturor)	24 korrik 2020